Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0614

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "AS Tech" SH.P.K., me Nr.Protokolli 614/23 të datës 24.08.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 04.08.2023 të "POLICIA E KOSOVËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së, me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1,në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve, me datë 06.10.2023 merr këtë:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e OE "AS Tech" SH.P.K. me Nr, Protokolli 2023/0614, e datës 24/08/2023, kurse vendimi i AK "POLICIA E KOSOVËS" lidhur me aktivitetin e prokurimit "*Furnizim me klima për objektet e PK-së"* me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i tarifave të ankesave në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrojnë kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.06.2023, Policia e Kosovësnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me klima për objektet e PK-së.

Me 04.08.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë OE "KIGA" SH.P.K. Me 08.08.2023, OE "AS Tech" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të cituar. Me datë 14.08.2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit ekonomik ankues dhe ka vërtetuar Vendimin e lartcekur.

I pakënaqur me Vendimin e AK-së, Operatori ekonomik "AS Tech" SH.P.K., me 24.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 614/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankese sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues" AS Tech " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi i parë (I) Ankuesi pretendon*: "Ne vendimin e AK-së ofertën tonë e ka cilësuar si të eliminuar dhe nuk pajtohemi me këtë sidomos me arsyen e eliminimit kur AK potencon se oferta jone ka pasur katalog qe ska pasur shumë të dhëna. Kjo arsye tregoj se komisioni nuk ka qenë i interesuar të vlerësoj ofertën tonë si duhet dhe me shumë, sepse mungesa e të dhënave nuk e benë të papërgjegjshme një ofertë. Katalogun e krijon vete kompania prodhuese ose furnizuese*

në Kosovës dhe ne nuk jemi përgjegjës për këtë ose oferta jonë nuk është e papërgjegjshme pse një katalog është i mangët. Komisioni ka mundur të kërkoj sqarime tjera ose të bëjë hulumtim përmes furnizuesit të bendit ose tregut, qasja në të dhëna ne ditët e sotme është shume e lehtë. Përfundimisht lidhur me këtë pretendim konsiderojmë se komisioni nuk ka bërë vlerësim si duhet sepse nuk e ka respektuar legjislacionin e prokurimit për të bërë vlerësimin si duhet dhe për të shfrytëzuar të drejtën e informacioneve shtesë."

Pretendimi i dytë (II) Ankuesi sqaron: "Nga Qasja qe patën kuptuam se AK ka shpërblyer një ofertë të papërgjegjshme, fillimisht OE në dokumentin e dorëzuar në ofertë me titull Katalogu ka dy faqe, në faqen e parë është një foto e klimave dhe është cekur brendi me kodin TAC-12CHSD/XA73I (https://www.tcl.com/global/en/air-conditioners/tac-chsaxa73i) ndërsa në faqen e dytë është shkruar brendi TAC-12CHSD/XA73I (https://supermart.al/en/home-and-garden/household-appliances/climatecontrolappliances/airconditioners/kondicioner-tcl-tac-12chsd-xa71if-en/).
Automatikisht ky detaj e benë ofertën e papërgjegjshme dhe të eliminuar sepse OE nuk guxoj të ofertoj me dy modele të ndryshme. Nuk mund të pranohet një ofertë e përgjegjshme nëse oferton me dy modele të ndryshme, që nëse analizohen specifikimet teknike të tyre janë të ndryshme mes veti, por edhe me dosjen. Po edhe nëse i vlerësojmë këto brende nga shfletimi në google te brendi TAC12CHSA/XA73I nuk i ka specifikat e njëjta siç AK i ka kërkuar në aneksin 1 të dosjes, AK ka kërkuar klimat me klasë të energjisë me A (me tre plusa), ndërsa brendi i ka klimat me A(me dy plusa), d.m.th. me nivel me të lartë të harxhimit të energjisë elektrike. AK ka kërkuar gas R32 ndërsa nga shfletimi ne google shihet se ky brend e ka gazin R410, të bashkangjitur gjeni edhe dëshminë foto nga google të kodit që OE e ka dorëzuar në ofertë (Dëshmia e modelit të parë-gazi R410). Ndërsa nëse në google e shfletojmë brendin e dytë me titull TAC-12CHSD/XA73I dalin specifika qe nuk janë të njëjta me specifikat qe ka kërkuar AK në dosje dhe në Aneksin 1, klasa e energjisë është me A dy plusa ndërsa në dosje AK ka kërkuar me A tre plusa (bashkangjitur gjeni dëshminë me titull - Dëshmia e modelit te dyte klasa e energjisë). Kërkojmë po ashtu edhe arsyetim nga Komisioni ne veçanti ose AK në përgjithësi se si është bërë hulumtimi i vlefshmërisë se katalogute Ofertës se OE te rekomanduar. OE ka shume mundësi supozojmë qe ka bërë manipulim me fletën e te dhënave ne faqen e dyte, është munduar te i përshtatet specifikimeve te AK por ka dështuar sepse brenda vete " katalogut te tij" qe e ka prezantuar ka shkruar dy emra te modeleve, ne te njëjtin prezantim d.m.th. ne foto e ka emrin e brendin ndryshe ndërsa në specifikimet me poshtë të ndryshme."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE " AS Tech " SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 31.08.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 614/23 ndërsa me datë 11.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*"

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. OE ankues ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues duke pohuar cituar "*As Tech" SH.P.K nuk pajtohet me mendimin e eksperti qe lënda të kthehet ne rivlerësim dhe te kërkohen sqarime për OE e rekomanduar, kur shihet qarte se oferta e tij është e papërgjegjshme. Një oferte nuk mund te jete e përgjegjshme kur foto e pajisjes ne katalog ka një emërtim brendi ndërsa nga shfletimi ne internet i njëjti brend me atë emërtim nuk i ka specifikat siç i ka prezantuar poshtë katalogut OE. Përveç qe s është e lejuar te ofertohet me dy brende, nuk duhet te lejohen edhe ndryshimet e specifikave te dorëzuara me ato qe janë ne treg. Te dy bendet qe OE i ka dorëzuar nuk i plotësojnë specifikimet teknike te AK-se, sa i përket llojit te gazit, klasës se energjisë e te tjera.".* Si dhe AK ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues duke pohuar cituar: "*AK gjate procesit të vlerësimit ekzaminimit krahasimit të ofertës se OE te rekomanduar për kontratë qe ka ofertuar me dy brende në ofertën teknike nuk qëndron pasi OE në faqen e parë të katalogut ka prezantuar vetëm foto e klimës si duket klima me kapacitetin 12000BTU, ndërsa ne fletën e dyte i ka te gjitha specifikat teknike te kërkuara nga ana e AK sipas Aneksit 1 dosjes se tenderit dhe janë ne harmoni me ato te kërkuara. AK gjithashtu gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit krahasimit të tenderi ka verifikuar edhe në internet dhe ekziston klima, katalog me të dhënat e kërkuar ketë e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues i kësaj lende. OE i rekomanduar për kontratë ofertën teknike për klimat 12000BTU i ka ofruar në harmoni të plotë me kërkesat e AK sipas Aneksi 1 dosjes së tenderit."*

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " AS Tech " SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0614 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar *pasi që Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, sqaron se: Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:"Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog* ***broshurë të prodhuesit me përshkrim detal të produkteve*** *në DT Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 1: OE duhet te dorëzojë Katalog broshure të prodhuesit me detajet e nevojshme për vlerësim, me selektim ose nënvizim në mënyrë të qartë për secilin artikull".*

*Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues " AS Tech " SH.P.K., sqaron se kërkesa e lartë cekur, e vendosur nga AK në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë është mjaftë e qartë, megjithatë edhe për kundër kërkesës së dosjes së tenderit OE ankues "AS Tech " SH.P.K., gjatë tenderimit në ofertën e tij, nuk ka dorëzuar "****katalog broshurë të prodhuesit me përshkrim detal te produkteve ne DT",*** *si rrjedhojë, AK përkatësisht Komisioni Vlerësues, ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, lidhur me sqarimin e tenderëve. AK me datë 21.07.2023 i ka dërguar Operatorit Ekonomik ankues "AS Tech " SH.P.K., Letër Standarde (B47) e kërkesës për sqarimin e tenderit ku thuhet: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog broshur të prodhuesit me përshkrim detal te produkteve ne DT Dëshmi 1: OE duhet te dorëzojë Katalog broshure të prodhuesit me detajet e nevojshme për vlerësim, me selektim ose nënvizim në mënyrë të qartë për secilin artikull Ju nuk keni dorëzuar katalog/broshurë te prodhuesit me përshkrim detal te produkteve sipas kriterit te kërkuar. Ju lutem na dërgoni katalogun e prodhuesit sipas kriterit qe është kërkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate".*

Ndërsa, OE ankues me datë 26.07.2023 në përgjigjen e publikuar ne platformën e-prokurim ka dorëzuar katalog si më poshtë: Eksperti shqyrtues, bazuar në kërkesën e lartcekur të vendosur nga AK në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, ka konsideruar që, kërkesa në fjalë ka qenë mjaftë e qartë, po ashtu, fakti se gjatë vlerësimit të tenderit, AK përmes Letrës Standarde (B47) të kërkesës për sqarimin e tenderit të dërguar nga AK për OE ankues, të cilit i bëhet e qartë për dokumentacionin që duhet sjellur sipas kërkesës së dosjes se tenderit, pra, edhe për kundër sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK, katalogu i dorëzuar nga OE ankues, nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, rrjedhimisht nuk i përmbush specifikat e dosjes së tenderit Aneksi 1, si i tillë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit të vendosur nga AK. Gjithashtu, lidhur me pretendimin se, "komisioni nuk ka bere vlerësim si duhet sepse nuk e ka respektuar legjislacionin e prokurimit për te bere vlerësimin si duhet dhe për te shfrytëzuar te drejtën e informacioneve shtese", ky pretendim i OE ankues në këtë pikë ***nuk qëndron.*** *Dosja e tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.*

Pretendimi i dytë (II) ankimor: *Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, përkatësisht ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, gjithashtu, duke marrë parasysh kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), po ashtu shkresat e lëndës në platformën e-prokurim, sqaron si në vijim: Siç e kemi potencuar edhe në pretendimin ankimor paraprak, Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:"Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog broshurë të prodhuesit me përshkrim detal te produkteve ne DT Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 1: OE duhet te dorëzojë Katalog broshure të prodhuesit me detajet e nevojshme për vlerësim, me selektim ose nënvizim në mënyrë të qartë për secilin artikull". OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një Klimë "Modeli TCL me kodin TAC-12CHSA/XA73I", ndërsa, në foton e dytë, një katalog me përshkrim detal të Klimës "Modeli TCL me kodin TAC-12CHSD/XA73I", e cila është paraqitur me ngjyrë të verdhë.*

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e lartcekura, gjithashtu duke u bazuar në kërkesën e lartë cekur në dosjen e tenderit, konsideron se, katalogu i Klimës i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, "Modeli TCL me kodin TAC-12CHSD/XA73I", me përshkrim detal e cila është paraqitur me ngjyrë të verdhë, e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe në njoftimit për kontratë, si rrjedhojë nga ky specifikim i dhënë në katalog, është konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikave teknike te Aneksi 1 i dosjes. Por, meqenëse ka mos përputhje dhe paqartësi ndërmjet "Modelit TCL me kodin TAC-12CHSA/XA73I", dhe "Modelit TCL me kodin TAC-12CHSD/XA73I", gjithashtu fakti se gjatë kërkimeve në internet paraqiten specifikime të ndryshme sa i përket këtij modeli, andaj për ta qartësuar më mirë këtë situatë, lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit, AK të kërkoi sqarim shtesë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës të paraqitura në këtë raport, me qëllim të vlerësimit të tenderit në përputhje me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, i propozon Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës, të Anuloi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, si dhe gjatë ri-vlerësimit, për ta qartësuar më mirë këtë situatë, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit katalogu i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, AK të kërkon sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K.Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht

dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K. i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, lidhur me sqarimin e tenderëve. Katalogu i dorëzuar nga OE ankues (për kundër sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK), bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, rrjedhimisht nuk i përmbush specifikat e dosjes së tenderit Aneksi 1, si i tillë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit të vendosur nga AK. Por Paneli shqyrtues konstaton se për shkak të mos përputhjeve dhe paqartësive ndërmjet "Modelit TCL me kodin **TAC-12CHSA/XA73I"**, dhe "Modelit TCL me kodin **TAC-12CHSD/XA73I** (specifikime të ndryshme sa i përket këtij modeli**),** kurse AK pretendon se kjo ka ndodhur vetëm per te paraqitur foton se si duket klima dhe nuk korospodon me dy modele te ndryshme ne ofertim, irekomanduari ka ofertuar konfom specifikacioneve teknike te ofruara në DT, megjithatë për ta qartësuar këtë situatë, lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit, të verifikohet pohimi ankimor nëse bendet qe OE i rekomanduar për kontratë i ka dorëzuar ai i plotësojnë specifikimet teknike, sa i përket llojit te gazit, klasës se energjisë e te tjera andaj AK të kërkoi sqarim shtesë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-se. Rrjedhimisht me qëllim të vlerësimit të tenderit në përputhje me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik u vendos si në dispozitiv ashtu që Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, si dhe gjatë ri-vlerësimit obligohet AK për ta qartësuar këtë situatë, lidhur me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit, katalogu të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, *AK të* veproj sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shoh ligji në mënyrë selektive andaj bazuar ne pretendimet ankimore dhe atë qe u përshkrua si me larte, psh vendosi qe kjo procedure e prokurimit te kthehet ne ri vlerësim me qellim që të trajtohen ne mënyrë te drejte kërkesat, kundrejt ofertave sipas dispozitave dhe parimeve te prokurimit publik ne fuqi.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Njëkohësisht e obligon Ak që gjatë rivlerësimit të

ofertave të veproj konformë FDT dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejtë ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenit 7, 59, 69 të LPP lidhur me nenit 40, te RRPP-së

Paneli shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh edhe nenin 59 paragrafi 4 se edhe nëse do të kishte lëshime të vogla eventuale, që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara me njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, për panelin shqyrtues do të konsideroheshin jo të rëndësishme në raport me interesin publik dhe fondet publike, e për të cilat fonde dhe burime publike, autoritet kontraktuese janë të obliguara ti përdorin në mënyrë ekonomike.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siq parashihet në nenin 6 të LPP-ës, Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimin të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese ne Republikën e Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke respektuar dhe duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: